

UDHËZIM
Nr.17, datë 6.6.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEKLARIMIN E SHPENZIMEVE TË
FUSHATËS ZGJEDHORE, TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 6.6.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 144 dhe nenit 145/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë procedurat për pranimin, regjistrimin, deklarimin dhe raportimin e dhuratave që marrin subjektet zgjedhore, nga personat fizikë dhe juridikë, privatë vendas për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.

Neni 2

Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, kandidatët e tyre, si dhe koalicionet zgjedhore janë të detyruar të regjistrojnë dhe të deklarojnë sipas formularëve tip bashkëlidhur këtij udhëzimi çdo dhuratë apo përfitim për fushatën zgjedhore.

Neni 3

Partitë politike, kandidatët e tyre, kandidatët e pavarur, si dhe koalicionet mund të përfitojnë për fushatën e tyre zgjedhore dhurata nga persona fizikë ose juridikë, privatë vendas.

Neni 4

Kanë të drejtë të japin dhurata persona fizikë ose juridikë, privatë vendas, si dhe individë.

Neni 5

1. Dhuratat të cilat mund t’u jepen subjekteve zgjedhore ndahen në tre lloje:
 - Dhurata në vlerë monetare;
 - Dhurata në shërbime;
 - Dhurata në sende.
2. Asnjë dhurues nuk mund t’i japë të njëjtit subjekt zgjedhor dhurata në vlerë më të madhe se 1 milion lekë ose kundërvleftën në sende apo shërbime.

Neni 6

Subjekti zgjedhor, të cilit i ofrohen dhurata në vlera monetare, sende ose shërbime, sigurohet paraprakisht për identitetin e dhuruesit dhe pasi e pranon dhuratën e regjistron atë duke e përshkruar

në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Neni 7

Subjekti zgjedhor duhet të deklarojë çdo dhuratë të marrë në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve, sipas formularit Model 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 8

Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, partitë politike dhe kandidatët e pavarur do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Neni 9

Për secilën prej dhuratave, pas vlerës në lekë do të shënohet:

- a) Shkronja M (për dhuratat në mjete monetare);
- b) Shkronja S (për dhuratat në sende);
- c) Shkronja SH (për dhuratat në shërbime).

Neni 10

Subjekti zgjedhor do të regjistrojë dhe deklarojë në formularin Model 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, të gjitha shpenzimet që do të kryejë në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 11

Partitë politike u kërkojnë kandidatëve të tyre për deputetë që t'u dërgojnë të plotësuar formularët Model 1 dhe 2, ku pasqyrohen të gjitha dhuratat dhe shpenzimet e kryera në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 12

Partitë politike i përfshijnë këto të dhëna në formularët Model 1 dhe Model 2, ku ata kanë regjistruar dhe deklaruar dhuratat e përfituara prej tyre, dhe i dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 45 ditë pas datës së zgjedhjeve.

Neni 13

Çdo faqe e formularëve Model 1 dhe 2, pas plotësimit do të vuloset dhe nënshkruhet prej kryetarit të partisë, ose sipas rastit, do të nënshkruhet prej kandidatit të pavarur.

Neni 14

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



Model 1

TABELA E DHURATAVE TE PËRFITUARA NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR
JURIDIKË PRIVATE VENDAS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005

NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NE LEK	SUBJEKTI TË CILIT I ËSHTË BËRË DHURATA (NËSE ËSHTË I NDRYSHËM NGA PARTIA)	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
SHUMA TOTALE E DHURUAR						

Shifër (fjalë) lek

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____






TABELA E SHPENZIMEVE TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR _____ PËR FUSHATËN ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005



SUBJEKTI ZGJEDHOR